



Dt: 13.06.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 68, paragrafi 3, i ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 datë 04.06.2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë: 04.06.2008), neni 4, paragrafi 1 dhe neni 6, paragrafi 1, pika 1.3 i Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit me publik në Komuna i datës 31.12.2018, me datën 13.06.2023 shpallë këtë:

NJOFTIM

Për mbajtjen e konsultimit publik me qytetarë, OJQ-të dhe grupet e interesit për Kornizën Afatmesme Buxhetore, KAB 2024 – 2026.

Të nderuar bashkëqytetarë të Komunës së Gjakovës, përfaqësues të shoqërisë civile – OJQ, grupe të interesit dhe të gjithë ju të interesuar, ju njoftojmë se të Hënën me datën 19.06.2023 me fillim nga ora 11:00, në Sallën Solemne të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi” (Kati II) do të mbahet takim i hapur me qytetarë për konsultimin dhe shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, KAB 2024 – 2026 të Komunës së Gjakovës.

Në takim do të informoheni mbi KAB-in Komunal dhe do të mund të drejtoni pyetje dhe kërkesa për të cilat do të ju përgjigjet Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, njëkohësisht kërkesat tuaja mund të përfshihen në KAB.

Pjesëmarrja juaj në këtë takim dëshmon aktivizmin qytetar dhe përfshirjen tuaj në vendimmarrje.


Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës